Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0913

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE N.T.SH. " DONI - ING ", kundër Njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pjesë për riparimin e motorrave për kamion dhe ngarkuese" me numër të prokurimit 12997 12998-24-8628-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Trepça SH.A., më 26/11/2024, mori këtë:

Vendim

1Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE N.T.SH. "DONI - ING", me nr. 2024/0913 , e datës 26/09/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pjesë për riparimin e motorrave për kamion dhe ngarkuese" me numër të prokurimit 12997 12998-24-8628-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Trepça SH.A.

2.Anulohet Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Trepça SH.A., në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit, dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

3.Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatoreve Ekonomik N.T.SH. "DONI - ING"

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 21.08.2024 Trepça SH.A në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pjesë për riparimin e motorrave për kamion dhe ngarkuese" me numër të prokurimit 12997 12998-24-8628-1-2-1.

Ndërsa me datën 17.09.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE "Lexalko" Sh.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 55,000.00€.

Me 20.09.2024 OE N.T.SH. " DONI - ING ", ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 23.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 26.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE N.T.SH. " DONI - ING ", me nr. 0913/2024 lidhur me aktivitetin "Furnizim me pjesë për riparimin e motorrave për kamion dhe ngarkuese" me numër të prokurimit 12997 12998-24-8628-1-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues N.T.SH. " DONI - ING ", janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : "Ndërmarrja jone N.T Sh. "DONI-ING", me seli ne Gllogoc, ka aplikuar ne tenderin me nr. Prokurimit 12997 12998-24-8628-1-2-1,ku me shkresën e datës, 17.09.2024, jemi njoftuar ,se tenderi i jonë është Refuzuar, për këto arsye: Komisioni i vlerësimit konstaton se oferta e jonë nuk është e përgjegjshme për shkak se ne kemi dorëzuar certifikatën për cilësi ISO 9001,me afat të skaduar. Nuk është kontestuese se oferta e ndërmarrjes tone ka qene ofertë më e lirë për vlerën prej 2,968,35 euro, dhe edhe përkundër këtij fakti tenderi na është Refuzuar është e vërtete, se nga pa kujdesia kemi dorëzuar certifikatën ISO 9001:2015, me afat skadimi deri me 12.06.2017, por nuk është kontestuese fare se ndërmarrja jonë e ka poseduar dhe e posedon certifikatën tjetër ISO 900l:2015, me nr. 01 100 1700308, e lëshuar me datën 06.07.2023 me afat skadimi deri me datën 05.07.2026. Provë: Certifikata, ISO 9OO1:2O15, me nr. 01 l00 1700308, e lëshuar me datën-06.07.2023 me afat skadimi deri me datën 05.07.2026. Ne mendojmë se për, një pa kujdesi dhe derisa ne e kemi poseduar dhe posedojmë Certifikatën me afat skadimi deri me 2026 dhe oferta në vlerë më të vogël në shumen prej 2,968,35 euro, nuk ka qene dashtë të refuzohet dhe ka mundur qe t€ ftohet ndërmarrja dhe të pyetet se a e posedon certifikatën me afat të pa skaduar ajo, dhe ne se ndërmarrja nuk do ta posedonte një certifikate me afat t€ pa skaduar atëherë duke u nisur edhe nga vlera me e vogël e ofertës te Aprovohet e jo të Refuzohet. Shuma prej 2,968,35 euro, me e vogël se sa oferta e ndërmarrjes tjetër nuk është ndonjë shume e vogël, sa për t'u interesuar se paku për plotësimin e dokumentacionit të ndërmarrjes me ofertën me të lirë për afër 3000 euro. Paraja e cila veç harxhohet në tenderin e shpallur, është para publike dhe për çdo cent te saj organet kompetente janë te detyruar te intereson qe të hargjohet sa me pak qe është e mundur, e jo për një telefonate te hargjohen afër 3,000 euro me shumë. Ndërmarrja, e jone, ka ofertuar në shumë tenderë të tjerë dhe te gjitha obligimet qe i ka poseduar i ka përmbushur me kohe dhe me rregull, dhe asnjëherë nuk iu ka shmangur obligimeve qe i ka pasur ndaj organeve shtetërore te Republikës se Kosovës. Ne jemi të bindur se Organi i Shqyrtimit Publik, OSHP, do te i shqyrton të gjitha dëshmitë, kushtet dhe rrethanat dhe pas analizimit te gjitha dokumenteve te dorëzuara por edhe do ta merr për bazë,

gabimin e pa qëllimshëm, të ndërmarrjes tonë, duke u nisur nga fakti se veç certifikata e ISO 900I , ka ekzistuara te na ne edhe para ofertimit me afat deri në vitin 2026. Dëshmi Shiko certifikatën. Besoj se edhe ju jeni të vetëdijshëm, se njeriu gjatë punës rutine ,qofte ditore e qoftë javore apo mujore munde te gabon andaj edhe ne nga ngarkesa e punës, kemi gabuar qe në vend të certifikatës, me afat deri ne vitin 2026, e kemi dorëzuar certifikatën me afat te skaduar Andaj, te i nderuar, te i analizoni dëshmitë dhe kujdesin me te madh te mundshëm, dhe pas analizimit dhe shqyrtimit te kujdesshëm, Ankesën ne fjale ta aprovoni ne tersi te Bazuar. Organi i Shqyrtimit Publik, si organ me kompetente ne këtë qeshtje do ta vërteton nje gjendje krejtësisht tjetër faktike, nga ajo e autoritetit kontraktues , "TREPQA",, dhe sigurisht e tere gjendja ne fjale do te ndryshon ne favorin tone, për shkak te ofertës shumë më të lire dhe plotësimit të gjitha kushteve dhe kritereve ligjore , në baze të dispozitave ligjore ne fuqi. Shpresojmë, se një gabim i pa qëllimshëm, nuk do të na ndëshkon si ndërmarrje e ndershme dhe me autoritet te madh ne çdo aspekt. Shpresojmë se Organi i Shqyrtimit Publik, do te merr për shqyrtimin ankesën ne fjale sa me pare qe është e mundur, dhe do te vendoset n€ favorin tone. Shpresojmë, se nëse është e nevojshme ,lidhur me ketë qështje, do t€ na ftoni n€ OSHP, për të ju sqaruar edhe me tepër lidhur me një gabim te pa qëllimshme, për faktin se çdo herë kemi qen€ dhe do te jemi bashkëpunues me organet e Republikës se Kosovës.."

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: "Pas analizimit të kërkesës tuaj për ri-shqyrtim në aktivitetin c prokurimit me nr. 12997 12998 -24- 8628-1-2-1, ku ju keni shprehur pretendimet e juaja, kërkesa juaj refuzohet si c pa bazuar. Të gjitha pretendimet e juaja nuk qëndrojnë sepse ju edhe në kërkesë për rishqyrtim keni deklaruar që keni bërë gabim Teknik gjatë dorëzimit të ofertës. Ju bëjmë me dije, se nëse nuk c kishit ngarkuar fare certifikatën ISO në ofertë dhe pasi që ju keni qenë me çmimin më të ulët, AK do të kishte kërkuar gjatë vlerësimit te ofertave sqarime shtesë përmes platformës dhe formës; Letër standarde e kërkesës për sqarim tenderi sipas LPP-së neni 69, mirëpo ju në këtë rast keni ofruar dokumente me- afat të skaduar. Si provë do ju bashkëngjisim certifikatën ISO që ju e keni dërguar në ofertë."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 03/10/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0913/2024, ndërsa me datë 08/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0913 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është Pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është përgjigjur lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE N.T.SH. " DONI - ING ", eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0913 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) : "Vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur me ankesën e OE "DONI ING " N.T.SH. Eksperti shqyrtues i prokurimit, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë në kontekstin e përgjithshëm të shqyrtimit dhe analizimit të gjitha shkresave të lëndës në platformën e-prokurimi, sipas vlerësimit profesional dhe të pavarur në kuptim të nenit 114 të LPP-së, paraqet të gjeturat. Pretendimet ankimore lidhur me mos plotësimin e kërkesave të DT – Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të nenit 9.1&9.2: Përmes këtij pretendimet që janë të ndërlidhura me thelbin e pohimeve ankimore, OE ankues ka pretenduar se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP dhe Aneksin 1 të DT-së (shih secilin pretendim të përshkruar si më sipër, pa nevojë të përshkruhen në detaje sërish). Konstatimi i ekspertit shqyrtues për pretendimet si më lartë : Eksperti shqyrtues, sqaron se duke marrë parasysh se pretendimet e lartcekura janë të ndërlidhura me objektin e njëri-tjetrit, është vendosur që të trajtohen dhe shqyrtohen si tërësi, bashkërisht. Pas shqyrtimit të pretendimit ankimore, analizimit të shkresave të kësaj lënde të dokumentuara në platformën e-prokurimi, duke u mbështetur në LPP si ligj material dhe rregullat e prokurimit publik (RRPP), eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron i bazuar pretendimi e lartcekura të OE ankues, për faktin se AK me aktet dhe veprimet e saj e ka respektuar nenin 59 të LPP-së, në paragrafin 4, ku thuhet: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.." Ndërlidhur me këtë situatë, eksperti shqyrtues vlerëson se veprimet dhe aktet e AK-së janë në përputhshmëri me ligjëmërinë e procesit të prokurimit sipas nenit 24 paragrafi 2 të LPP-së, ku thuhet: "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. AK në Dosjen e tenderit të publikuar më datë: 21.08.2024, në nenit 9.1&9.2 te Kapaciteti teknik dhe profesional , është kërkuar si : 1.OE duhet të ofroj certifikatën për cilësi ISO standard nga prodhuesi. 1.Çertifikata valide ISO 9001 2015. Ndërsa në ofertën e dorëzuar nga OE ankues , ka ofruar certifikate me afat të skaduar ku një gjë të tillë e ka pohuar edhe vetë në ankesën e parashtruar ISO e dorëzuar nga OE. Eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron i bazuar pretendimi lartcekur i OE ankues, për faktin se AK me aktet dhe veprimet e saj ka vepruar në harmoni me nenin 59, paragrafi 4 i LPP-së. Ky pretendim ankimor i OE është i Pa Bazuar."

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për

të vendosur në aspektin meritor.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij nuk është i pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë nuk e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes, për shkak se i njëjti nuk ka marrë për bazë të gjitha provat e ofruara nga OE ankues.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimi ankimor rreth arsyes së eliminimit të OE ankues është i bazuar dhe AK në kundërshtim me dispozitat ligjore në këtë rast nenin 72 të LPP, nuk ka marrë parasysh provat e ofruara në kërkesë për ri-shqyrtim sa i përket Certifikatës ISO 9001 2015, e cila është me validitet dhe ky validitet sipas këtij dokumenti të ofruara është para publikimit të njoftimit për kontratë. Nëse eventualisht AK ka dyshime rreth këtij dokumenti atëherë konform nenit 52.7 të LPP mund të kryejë një kontroll efektiv.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe përgjigjet e ekspertit, përgjigjen e OE ankues ne raportin e ekspertit, përgjigjen e AK ne raportin e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e OE duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues në kuptim edhe të nenit 6 të LPP ka vendosur qe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit – Trepça SH.A., të anulohet dhe ky aktiviteti i prokurimit të kthehet ne Ri-vlerësim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me pjesë për riparimin e motorrave për kamion dhe ngarkuese" me numër të prokurimit: 12997 12998-24-8628-1-2-1.

Andaj, paneli shqyrtues në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe parimet themelore të tij, Autoriteti Kontraktues (AK) ka për detyrë të sigurojë që procesi i prokurimit të jetë efikas, transparent dhe i drejtë, duke trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese. Kjo përfshin edhe detyrimin për të garantuar përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike, duke mos kontribuar dhe prolonguar këtë aktivitet të prokurimit në pafundësi, sikurse në rastin konkret. Përfundimisht, bazuar në sqarimet e mësipërme, rezulton për këtë panel se AK, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe nenin 60 i LPP-së si kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm më çmimin më të ultë. Po ashtu, Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7 te LPP-së përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Megjithatë, Paneli sqaron se në rast se ka dyshime eventuale të cilat mund të lindin gjatë procedurës së mëtejshme ose nëse lindin pyetje të reja mbi vërtetësinë e informacioneve të dhëna. AK, ka të drejtën dhe përgjegjësinë ligjore të ndërmarrë veprime të mëtejshme. Kjo përfshin zbatimin e nenit 59 dhe nenit 52.7 te LPP-së, i cili lejon kryerjen e kontrolleve shtesë efektive mbi informacionet dhe dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Përdorimi i këtyre neneve garanton një proces të drejtë dhe të paanshëm për OE, por njëherësh duke iu dhënë mundësi edhe AK-së të vlerësojë në mënyrë të plotë dhe të paanshme çdo aspekt të ofertës dhe të dokumentacionit të paraqitur, dhe të sigurojë që të gjitha vendimet të jenë të bazuar mbi prova dhe analiza të qarta dhe transparente.

Prandaj, obligohet autoriteti kontraktues që gjatë ri-vlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit, njoftimit për kontrate dhe specifikimeve teknike – aneksit 1 të FDT-së, duke respektuar dispozitat ligjore të LPP-së, duke pas parasysh, kriteri kryesor për dhënie të kontratës të përcaktuar në dosje të tenderit. Paneli Shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në pajtim të plotë me dispozitat ligjore të **nenit 59 të LPP-së** dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe **nenin 60 i LPP-së** si kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm më çmimin më të ultë.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Trepça SH.A.**
- OE - **N.T.SH. " DONI - ING "**
- Arkivës së OSHP-së: